

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 693/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Vjosa Gradinaj Mexhuani Kryetare, Kimete Gashi Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "N.P.T.Acvilla", me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me lende djegëse-dru dhe pelet ngrohje sipas Lot 1 dhe Lot 2 -Ritender" me nr. të prokurimit,644-22-10672-1-1-1 ,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrrisë, më datën 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e GOE "N.P.T.Acvilla", me seli në Prishtinë, nr.693/22, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me lende djegëse-dru dhe pelet ngrohje sipas Lot 1 dhe Lot 2 -Ritender" me nr. të prokurimit,644-22-10672-1-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrri.
2. Mbetet në fuqi, njoftimit Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës B58, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me lende djegëse-dru dhe pelet ngrohje sipas Lot 1 dhe Lot 2 -Ritender" për LOT 1 me nr. të prokurimit,644-22-10672-1-1-1 ,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrri.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.
4. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

5. Konfiskohet tarifa për ankesë e GOE“N.P.T.Acvilla”,me seli në Prishtinë konfom nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 21.11.2022,ka pranuar ankesë e (protokolluar ne OSHP me dt.24.11.2022) nga GOE“N.P.T.Acvilla”,me seli në Prishtinë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lende djegëse-dru dhe pelet ngrohje sipas Lot 1 dhe Lot 2 -Ritender” me nr. të prokurimit,644-22-10672-1-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Vushtrrisë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 693/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, Vlera e parashikuar e kontratës: për Lot 1 dru-lëndë djegëse është 306.400,00€.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues me datën 09.11.2022,ka publikuar B58 Njoftim për Kontratë dhe letër standarde për dhëne të Kontratës.

Me datën 11.11.2022,GOE ankues ju ka leju qasje ne dokumentet të tenderit, të rekomanduar për kontratë përveç dokumenteve financiare të cilat janë cilësuar si konfidenciale nga ana Autoritetit Kontraktues.

Me datë 14.11.2022, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim të Njoftimit për Kontratë B58 të publikuar nga AK- Komuna Vushtrrisë.

Me datë 15.11.2022 AK- Komuna Vushtrrisë, ka refuzuar si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik, GOE “Furnizimi me lende djegëse-dru dhe pelet ngrohje sipas Lot 1 dhe Lot 2 -Ritender” me nr. të prokurimit,644-22-10672-1-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Vushtrrisë.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 09.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e GOE“N.P.T.Acvilla”, të hudhet poshtë si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së ,Paneli shqyrtues sqaron se ndër të tjera qellim i këtij nenit 7 të LPP-së është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Sa i për këtë pretendimit të OE ankues lidhur me shkeljen e nenin 7 të LPP-së, AK ka bërë shkelje të këtij nenit 7 të LPP-së sepse nuk i ka trajtuar të gjithë OE ne mënyrë të drejtë dhe të barabartë, Është shpërblyer OE “AOME” që është i papërgjegjshëm për Lot 1, derisa neve na është vlerësuar oferta e pasuksesshme, Paneli shqyrtues bazuar edhe ne raportin e eksperti vlerëson se nuk qëndron ky pretendim sepse gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nuk është vërejtur se ka pasur ndonjë shkelje në trajtim drejtë, në trajtimin e barabartë ,si dhe shpërblimi me kontratë ka qenë në harmoni me kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e ankues “N.P.T.Acvilla” e cila pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 24 të LPP-së ,paneli shqyrtues vlerëson se sa i përket pretendimit të OE ankues se AK ka pranuar dokumente jo relevante i njëjti nuk qëndron sepse AK ka pranuar dokumentet e parapara me NJK dhe DT. ashtu siç janë paraparë të njëjtat edhe janë pranuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3dhe 4 .

Paneli shqyrtues duke shqyrtuar pretendimin tjetër të OE ankues e cila pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 42 dhe 43 të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se sa i përket këtij pretendimi qëndron se në Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) në faqen e parë dhe në Letra standarde nuk janë datat e njëjta ,mirëpo i njëjti është publikuar në platformën e-prokurimit me datë 09.11.2022 të njëjtën datë është publikuar edhe Raporti i Vlerësimit dhe është e kuptueshme se data e publikimit merret për bazë dhe atë datë e krijon sistemi-platforma e-prokurimit me momentin e ngarkimit të Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58),andaj është një lëshim teknik i kuptueshëm dhe që nuk e ndryshon rezultatin final.

Përgjigje në Pretendimin nr.5.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 51 të LPP-se ,paneli shqyrtues thekson se sa i përket pretendimit se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe të përshtatshmërisë ,të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë sepse OE ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe ka sjellë të gjitha dokumentet e parapara me mbi përshtatshmërinë.

Përgjigje në Pretendimi nr.6 .

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 54 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti njoftojë kandidatet dhe tenderuesit e eliminuar, pasi që OE vetëm sipërfaqësisht e ka përmendur këtë pa e theksuar se çka nuk ishte në harmoni me këtë dispozitë, pra AK ka vepruar në harmoni me nenin 54 të LPP-së duke përdorur dokumentet standarde dhe përmes platformës së e -prokurimit ku i ka njoftuar tenderuesit po ashtu edhe OE ankues.

Përgjigje në Pretendimi nr.7

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, paneli sqaron se qellim i këtij neni 59 është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, ku fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit, ndërsa sa i prektë pretendimit se vlerësimi nuk është bërë komfor neni 59 të LPP, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: AK me mos zbatimin e procedurës ashtu siç duhet në pajtim me nenin 59 i ka shkelur të gjitha nenet e lartcekura me pretendimet se nuk i plotësojmë kërkesat 1,2,3 dhe 4 të cekura me Letrën Standarde të OE të pasuksesshëm, kërkesa që plotësohen nga ne si OE.

Gjithashtu i njëjti pretendon se është hequr një kriter që ka qenë i paraparë paraprakisht d.m.th. me rastin e ri tenderimit AK në bashkëpunim me OE e shpallur fitues e ka larguar kriterin dhe e konsideron si të kundërligjshme.

Sa i përket pretendimit për heqjen e kriterit me rastin e Ri-tenderimit AK ka vepruar duke i lehtësuar kriteret dhe kriteri i hequr, nënkupton se ka qenë i paraparë për të gjithë ofertuesit dhe për të gjithë është hequr.

Eksperti shqyrtues e jepe këtë Sqarim:

Për heqjen apo vendosjen e kriterëve OE kanë të drejtë të ankohen para hapjes së ofertave apo deri në afatin e parapare për sqarime e jo assesi tani pas vlerësimit të tenderëve,(e assesi për kriterin e paraparë në një tender tjetër) Sa i përket pretendimit tjetër se ka indice se OE i shpallur fitues është i paditur nga Agjencinë i pylltarisë së Kosovës APK,

Ky pretendim është jo relevant OE ka sjellur dëshmitë nga gjykata dhe vërtetimi i lëshuar nga gjykata e eliminon çdo dyshim të ngritur nga OE ankues .

Përgjigje në Pretendimi nr.8 .

Sa i përket pretendimit OE ankues "N.P.T.Acvilla"-Prishtinë e cila pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 65 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se qëllimi i këtij neni është pranueshmeria e kandidatëve –tenderuesve, pra pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse OE i shpallur fitues i ka përmbush te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT e sa i përket kriterit te hequr ne bashkëpunim me AK për ketë paneli e ka dhanë vlerësimin e tij ne përgjigjen ne pretendimin nr.7.

Përgjigje në Pretendimi nr.9 .

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues se Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë nuk e ka respektuar nenin 67 të LPP-së ,paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron, sepse edhe AK i ka hartuar të gjitha provat shkresore edhe OE i shpallur fitues i ka dorëzuar te gjitha provat shkresore siç janë paraparë me NJK dhe DT.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon panelit shqyrtues qe ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik, ta HUDHË POSHT -si të PA BAZUARË (për arsyen që u çekën më lart),dhe i rekomandon panelit shqyrtues që ta lë në fuqi Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësas e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.


Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka bërë vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së sepse nuk ekzistojnë shkeljet e pretenduara sepse vlerësimi është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, OE me çmim më të lirë i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe të njëjtin e ka shpallur fitues .

Paneli shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkalles se pare, Departamentit Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së Komuna Vushtrisë
- 1x1 GOE "N.P.T.Acvilla", me seli në Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.